



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

CN.nr.317/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Franciska Zhitija - Ymeri, kryetare, Rrustem Thaqi dhe Beshir Islami, anëtarë, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit: Njësia e A. B., (A.), me seli në P., rr.“M. K.”, nr., banesa nr. ., kundër debitorit: P.P.D.T.S., “K.”, me seli në G., për propozimin e kreditorit për përmbarim, përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur më 13.12.2024, merr këtë:

### A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike - përmbarimore të kreditorit: Njësia e A. B. (A.), me seli në P., rr.“M. K.”, nr., banesa nr. ., kundër debitorit: P.P.D.T.S., “K.”, me seli në G., me kompetencë lëndore është Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Graçanicë, të cilës shkresat e lëndës i dërgohen në kompetencë të mëtejme.

### A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Graçanicë, me aktvendimin Cp.nr. 16/20, të datës 24.02.2023, ka vendosur: I. Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Graçanicë shpallet jokompetente për të vepruar në këtë çështje juridike. II. Sipas formës së prerë të këtij vendimi, lënda do të kalojë në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë si gjykatë kompetente.

Gjykata Komeriale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin KPPP.nr. 1345/24 të datës 25.11.2024, ka vendosur: I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komeriale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Graçanicë, për të vendosur në çështjen juridike përmbarimore në mes të kreditorit Njësia e A. B. (A.), me seli në P., dhe debitorit P.P.D.T.S., “K.”, me seli në G., II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

Në bazë të nenit 25 paragrafi 2 të LPK-së, konflikti lidhur me kompetencën midis gjykatave të llojit të ndryshëm e zgjidhë Gjykata Supreme e Kosovës.

Në këtë rast Gjykata e Supreme e Kosovës, si gjykatë më e lartë dhe e përbashkët për gjykatat në konflikt ka kompetencë lidhur me zgjidhjen e konfliktit të kompetencës, ndërsa në bazë të nenit 15 paragrafi 3, të LPK-së, përcaktohet se: *“Zgjidhjen e konfliktit për kompetencë territoriale dhe zgjidhjen e konfliktit për kompetencë e cakton trupi gjykues prej tre gjykatësve”*.

Në këtë rast kemi të bëjmë me çështjen përmbarimore midis kreditorit: Njësia e A. B. (A.), me seli në P., i cili ka ushtruar propozim, për caktimin e përmbarimit, kundër debitorit: P.P.D.T.S., “K.”, me seli në G., për shkak të borxhit. Kreditori i ka propozuar gjykatës përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues, Marrëveshjes së Kredisë, ku parashihet se debitori i ka borxh propozuesit shumë më prej 40,311.00 €.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës lidhur me konfliktin e kompetencës në mes të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Graçanicë dhe Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i për Çështje Ekonomike, gjeti se kompetente lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike është Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Graçanicë, për arsye se:

Me nenin 1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, përcaktohet se: *“1. Ky ligj rregullon procedurën përmes së cilës gjykatat dhe përmbaruesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbarues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe”*.

Me nenin 12 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat nr.06/L-054, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 22, datë 18 dhjetor 2018, përcaktohet se: *“Gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe ”* .

Me nenin 13 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe 1.2, të Ligjit Nr. 08/L-015, për Gjykatën Komerciale, përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre; 1.2. të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate;...”*

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se në këtë rast me kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike-përmbarimore në këtë fazë të procedurës është Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Graçanicë, për faktin se palët në këtë çështje përmbarimore pasi që është lejuar përmbarimi, lënda ka qenë në Gjykatën Themelore dhe nuk kanë ushtruar ndonjë mjet juridik kundër vendimit për lejimin e përmbarimit, ndërsa kreditori nuk ka kërkuar që lënda të kalojë te përmbaruesi privat ashtu siç është përcaktuar me nenin 397 të LPP, andaj Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Graçanicë, mbi bazën e këtyre rrethanave nuk ka mundur të shpallet jokompetente në pikëpamje lëndore por është dashur të vazhdojë në trajtimin e rastit ashtu siç është përcaktuar

me dispozitat e LPP-së. Në rastet kur kemi të bëjmë me zbatimin e përmbarimit sipas propozimit të kreditorit në asnjë rast nuk mund të jetë kompetente Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së parë, sepse e njëjta vendos vetëm lidhur me mjetet juridike që paraqiten ndaj lejimit të përmbarimit dhe në rastin kur palët nuk kanë paraqitur mjet juridik (prapsim apo ankesë), në të gjitha këto raste kompetente për të gjykuar janë Gjykatat Themelore, varësisht prej kompetencës territoriale.

Nëse ndonjëra nga palët do të paraqiste ndonjë mjet juridik në këtë çështje përmbarimore, atëherë kjo çështje përmbarimore do të ishte në kompetencë të Gjykatës Komerciale, nëse plotësohen kushtet e përcaktuar sipas Ligjit për Gjykatën Komerciale të cekur më lart, sepse Gjykata Komerciale ka kompetencë lëndore që të vendosë për të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, ashtu siç është përcaktuar me nenin 13 paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale.

Nga sa u tha më lart, e në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË  
CN.nr.317/2024 datë 13.12.2024.

Kryetarja e kolegjit  
Franciska Zhitija - Ymeri